

TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR NDJEKJEN PENALE TË PERSONAVE
PËRGJEGJËS PËR SHKELJE TË RËNDA TË SË DREJTËS HUMANITARE
NDËRKOMBËTARE TË KRYERA NË TERRITORIN E ISH-JUGOSLLAVISË PREJ
VITIT 1991

DEKLARATA E DËSHMITARIT

TË DHËNA MBI DËSHMITARIN:

Gjuhë të shkruara:

Gjuhë të përdorura në intervistë: anglisht - shqip

Profesioni i tashëm: i papunë

I mëparshëm: oficer / mësues

Data e intervistës: 9, 10 dhe 12 korrik 2002 + 8 gusht 2002 + 13 dhe 17 prill 2007

Intervistues: Roel VERNONNEN dhe Pekka HAVERINEN, Hetues të Ekipit 07 (9, 10 dhe 12 korrik 2002 + 8 gusht 2002), David Re, Shazada Sultan, Elena Martin Salgado dhe Katrina Gustafson (13 dhe 17 prill)


Përkthyes: Mirlinda SARAQINI (9, 10 dhe 12 korrik 2002 + 8 gusht 2002)
Maklen Misha (13 dhe 17 prill 2007)

Emrat e të gjithë personave të pranishëm gjatë intervistës: të lartpërmendurit

Nënshkruar/Inicialet:



1



DEKLARATA E DËSHMITARIT

1. Që nga viti 1981 regjimi i Beogradit po përballej me protesta dhe demonstrata të shqiptarëve të Kosovës, që eskaluan më 1989 kur Beogradi i hoqi Kosovës autonominë.



Oficëret e APJ-së, që ishin shqiptarë etnikë të Kosovës, shpesh ngacmoheshin dhe merreshin në pyetje nga Sigurimi Ushtarak i APJ-së rreth aktiviteteve dhe vendndodhjeve të të afërmeve dhe miqve të tyre në Kosovë. Ishte një fushatë e organizuar kundër shqiptarëve etnikë brenda APJ-së dhe, si rezultat i kësaj, shumica e shqiptarëve u larguan nga APJ ose dhanë dorëheqje. Më 12 dhjetor 1989 unë po ashtu vendosa ta lëshoja APJ-në. U ktheva në Kosovë ku vazhdova të jetoja në fshatin Llukë e Poshtme në Kosovë, ku, në ndërkohë, e kisha ndërtuar një shtëpi.


2 Në fillim të vitit 1990 konkurova për vendin e punës së Shefit të RTP-së që ishte Radio Televizioni i Prishtinës. Mirëpo, ditën që e fitova këtë punë në ndërtesën e RTP-së u fut MUP-i (MPB-ja) të cilët përjashtuan dhe nxorën jashtë të gjithë të punësuarit dhe e mbyllën stacionin.

3. Unë pastaj gjeta një punë si mësimdhënës në një shkollë të mesme (Luigj Gurakuqi) ku jepja mësim në lëndën e “mbrojtjes dhe sigurisë”, që kishte të bënte me atë sesi civilët duhej të jepnin ndihmë të menjëhershme në raste emergjence, siç janë fatkeqësitë natyrore (si termetet et.). Nxënësit e shkollës ishin të përzier, serbë (5%) dhe shqiptarë (90%). E njëjta përqindje reflektohej edhe në numrin e arsimtarëve. Mirëpo nxënësit dhe arsimtarët ishin të ndarë sipas etnisë. Nxënësit serbë dhe ata shqiptarë duhej t'i ndiqnin mësimet në klasë të ndara. Social etni kishte klasët e veta dhe arsimtarët e vet në të njëjtën shkollë. Mirëpo drejtori i shkollës ishte gjithmonë një serb, i cili caktohej nga autoritetet.

Diskriminimi sistematik çoi deri te perjashtimi apo dorëheqja e shumicës së mësimdhënësve shqiptarë. E lashë shkollën në vitin 1992, sepse ne, mësimdhënësit shqiptarë, kishim refuzuar të mbanin mësim apo ta përfillnim programin mësimor që e kishin urdhëruar autoritetet.

4. Nga ajo kohë isha i papunë dhe fillova të bëja punë bujqësie në fshatin tim, që u bë i vetmi burim të ardhurash për mua. Mirëpo më 29 shtator 1993 u arrestova nga SUP-i (SPB-ja) i

 2 



Pejës dhe Deçanit, i dyshuar se kisha themeluar ushtri ilegale (milici) për ta shkëputur Kosovën nga Jugosllavia. Më dënuan me pesë vjet burg për aktivitete subversive kundër autoriteteve Jugosllave, dhe në mënyrë të veçantë për përpjekje për të shkëputur Kosovën nga Jugosllavia. Apelovala ndaj këtij dënimi dhe ma ulën në dy vjet. Më liruan në 15 shtator 1995. pasi u lirova vazhdovala të punoj në bujqësi meqë isha ende i papunë.

5. Në atë kohë nuk kisha dëgjuar kurrë për UÇK-në. Hera e parë që dëgjovala për UÇK-në ka qenë në vitin 1996 apo 1997 kur gazeta shqiptare "Koha Ditore" filloi ta përmendte ekzistencën e saj. Në të njëjtën kohë njerëzit po gjenin fletushka në oborret e veta rreth UÇK-së. Këto fletushka quheshin "Çlirimi" dhe botoheshin nga LPK-ja (Lëvizja Popullore e Kosovës) dhe në to theksoheshin disa ngjarje të caktuara siç ishte vrasja e Edmond HOXHËS dhe Zahir PAJAZITITI më 1997 në Vushtrri nga MPB-ja. Fotografitë e të vrarëve ishin në fletushka për ta tërhequr vëmendjen e njerëzve rreth këtyre ngjarjeve.

6. Hera e dytë që dëgjovala për UÇK-në ishte kur një grup prej tre apo katër individësh të armatosur, të veshur në uniforma të kamufluara me maska në kokë, dolën publikisht në funeralin e Halit GECIT, një mësues që u vra nga MPB-ja në fshatin Llaushë. Kjo u shpall po ashtu në "Kohën Ditore" dhe RTV-ja në Prishtinë i dha pamjet e funeralit. Kjo paraqitje e parë publikisht shkaktoi bukur njëfarë rrëmuje midis shqiptarëve, sepse në të kaluarën shqiptarët kishin ndjerë një mosgatishmëri ndaj qëllimeve të UÇK-së.

7. Në fillim të vitit 1998 UÇK-ja po bëhej gjithnjë e më publike dhe e famshme kur RTV-ja po shfaqte pamje të përplasjeve që zhvilloheshin midis MPB-së dhe UÇK-së në rajonin e Drenicës (siç ishte sulmi në trojet e familjes Jashari në Prekaz dhe pamjet e anëtarëve të vrarë të familjes Jashari).

8. Hera e parë që kam dëgjuar për praninë e UÇK-së në rajonin e Dukagjinit ishte kur MPB-ja sulmoi trojet e familjes Haradinaj në Gllogjan në fund të marsit apo në fillim të prillit të vitit 1998. Përpara këtij sulmi, disa oficerë lokalë të MPB-së ishin vrarë në Ratishë dhe pastaj në Gllogjan. Emri i parë i oficerit të vrarë në Ratishë ishte "Sillobodan" dhe ai ishte nga

Zjant 75 KH

Deçani. U përhapën fjalë se Daut Haradinaj e vrau oficerin e policisë në Ratishë nga afër me një armë zjarri, por këto ishin thjesht thashetheme.

9. Kur MPB-ja i sulmoi shtëpitë Haradinaj dhe fshatin Glllogjan, anëtarët e familjes Haradinaj dhe fshatarët e Glllogjanit po i mbronin shtëpitë e tyre. Më vonë dëgjova se, gjatë sulmit të MPB-së, fshati i Glllogjanit ishte mbrojtur dhe fortifikuar nga luftëtarë lokalë të armatosur, disa në uniforma të kamufluara dhe të tjerët në rroba civile. Këtë e mësova nga vëllai im Lah TETAJ të cilit ia kishin treguar njerëz nga Glllogjani kur shkoi për të ngushëlluar familjet e atyre që ishin vrarë gjatë sulmit. Sipas mendimit tim kjo rezistencë çoi në krijimin e UÇK-së në rajonin e Dukagjinit, sepse para kësaj ngjarjeje nuk kisha dëgjuar asnjëherë për kurrfarë ekzistence të UÇK-së apo të çkadoqoftë në këtë rajon.

10. Mund ta dëgjoja sulmin mbi Glllogjanin pasi që fshati i Llukës së Poshtme është 6 deri në 7 kilometra larg nga Glllogjani. Rreth orës 1500, mund t'i shihja edhe sulmet nga ajri që bëheshin nga helikopterët e MPB-së. Moti ishte i mirë dhe qielli ishte i kthjellët. Helikopterët përshkonin rrrathë në qiell dhe nganjëherë fluturonin afër Llukës së Poshtme.

11. Në atë kohë, kisha dëgjuar për familjen Haradinaj, por unë e njihja vetëm babanë, Ilmi Haradinajn, sepse më parë kishte qenë pronar i një dyqani në Kodrali kur unë isha fëmijë.

12. Pas sulmit të MPB-së e konsideroja jetën time në rrezik pasi që kisha qenë oficer ushtarak dhe dihej se MPB-ja kërkonte anëtarë të UÇK-së dhe po ashtu shqiptarët me një të kaluar në APJ. Ata mund të paraqitnin rrezik për MPB-në dhe të përdreshin nga UÇK-ja, për shkak të përvojës së tyre ushtarake. Vendosa ta lëshoja Llukën e Poshtme e të shkoja në Pejë, ku qëndrova tri-katër ditë në shtëpinë e shokut tim Taf KELMENDI , në afërsi të Zatrave, që njihej si një lagje shumë e qetë, ku mund të fshihesha nga MPB-ja.

13. Kur dëgjova që MPB-ja ishte tërhequr nga Glllogjani (përafërsisht 2 -3 ditë pas sulmit), vendosa të kthehesha në fshatin tim. Të nesërmen shkova në Glllogjan nga kureshtja dhe për të parë se çka kishte ndodhur në të vërtetë. Vura re shumë dëmtime materiale të shtëpive, të

[Handwritten signature]

[Handwritten initials]

[Handwritten signature]


shkaktuara nga goditjet nga ajri. Fshatarët ishin në panik sepse disa nga të afërmit e tyre ishin arrestuar nga MPB-ja dhe ende nuk dihej ku ishin. Nuk pashë asnjë ushtar të UÇK-së aty pari, së paku nuk vura re asnjë uniformë të UÇK-së.

14. Nja dy ditë pas sulmit mora pjesë në funeralin e tre apo katër fshatarëve meshkuj prej Gllagjanit që ishin vrarë gjatë sulmit. Një turmë e madhe njerëzish ishin mbledhur në një livadh për të marrë pjesë në ceremoni dhe është mbajtur një fjalim nga Fitnete RAMOSAJ nga fshati Carrabreg i Poshtëm, e cila ishte e afërt me Faton MAHMETAJN. Të pranishëm ishin po ashtu përfaqësues të partive të ndryshme politike, por nuk më kujtohen emrat e tyre.. Musa BERISHA nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Deçan (që e kishte organizuar varrimin bashkë me fshatarët e Gllagjanit) ka marrë pjesë në këtë funeral gjithashtu.


15. Më vonë mora vesh se Fitnete Ramosaj kishte qenë anëtare me rëndësi e UÇK-së për një kohë, prandaj ishte lejuar që ta mbante fjalimin në funeral. Ishte një fjalim shumë politik dhe patriotik në të cilin ajo i përshkroi të ndjerët si martirë dhe heronj dhe se populli i Kosovës duhej të zgjohej dhe të reagoje. Mirëpo, nuk pashë ndonjë ushtarë të UÇK-së në uniforma duke marrë pjesë në varrim. Kjo më bëri ta pyesja veten pse nuk kishte asnjë pasi që varrimi ishte e qartë se ishte përdorur për t'iu referuar luftës heroike kundër sulmuesve të MPB-së.

16. Nuk e di nëse anëtarët e familjes Haradinaj po merrni gjithashtu pjesë në varrim. Mendoj se babai, Ilmiu, mori pjesë në varrim, sepse më kujtohet se dukej shumë i brengosur. Nuk e di nëse bijt e tij morën pjesë në varrim gjithashtu, sepse në atë kohë ende nuk i njihja.

17. Pasi MUP-i u largua nga Gllagjani, zona përreth Gllagjanit kontrollohej nga burrat e fshatit. Disa ditë pas varrimit mësova se UÇK-ja kishte themeluar një mbrojtje të organizuar në fshatin Gllagjan dhe shërbim roje. Këtë ma thanë njerëzit që kishin qenë në Gllagjan për ngushëllime të familjet e të ndjerëve. Ndër ta ishte vëllai im, i cili më tha se kishte parë ushtarë të armatosur në uniforma. Disa prej tyre kishin shenja të UÇK-së në kapela dhe në uniformat e tyre. Mirëpo disa prej tyre ishin të armatosur, por të veshur në rroba civile. Vëllai më tha se i kishte parë ushtarët duke e përshëndetur njëri-tjetrin me grushtin e djathtë të koka.







Ata po ashtu komunikonin përmes radiove të dorës kur i kontrollonin njerëzit që e vizitonin fshatin, gjë që e bëri vëllain tim ta kuptonte se dikush e kishte komandën. Mirëpo ai nuk kishte parë askë që e kishte komandën apo që jepte urdhra.

18. Në hyrje të fshatit vëllai po ashtu e kishte vënë re një postblok, ku kishte ushtarë të armatosur të UÇK-së nga fshati. Disa ishin të veshur në uniforma të kamufluara, të tjerët në rroba civile.

19. Unë personalisht e pashë këtë postblok kur shkova në Glllogjan një javë apo dhjetë ditë pas vëllait tim. Ky postblok ishte në hyrje të fshatit dhe përbëhej nga njëfarë barriere. Kishte ushtarë të armatosur, të veshur në uniforma të kamufluara.

20. Shkova ta shihja fshatin Glllogjan sepse doja të dija se çka po ndodhte atje dhe doja ta takoja Shtabin e UÇK-së në Glllogjan. Shkova në Glllogjan sepse Glllogjani njihej si epiqendra e UÇK-së pas sulmit të MUP-it. E kisha kuptuar se pas varrimit shqiptarët në rajon po tregonin gjithnjë e më shumë simpati dhe respekt për UÇK-në rreth fundit të marsit dhe fillimit të prillit dhe disa nga fshatrat përreth Glllogjanit tashmë kishin filluar t'i themelonin Shtabet e veta të UÇK-së, siç është Dubrava, Baballoqi, Gramaçeli, Shaptej dhe Lumbardhi. Krijimi i këtyre shtabeve ishte njohuri publike në atë kohë, por shtabin e Lumbardhit e pashë dhe vetë meqë ishte afër fshatit tim. E di se në atë kohë kamandant i fshatit Gramaçel ishte Ali Avdija (i njohur po ashtu edhe si "Baraba").

21. Fshati im nuk kishte reaguar ende, sepse po pritnin reagimin tim personal. Fshatarët e fshatit tim dhe të disa fshatrave fqinjë kishin deklaruar se do t'i bashkoheshin UÇK-së vetëm në ditën kur unë do ta vishja uniformën e UÇK-së

22 Kështu, meqë po më shtoej presioni, sepse doja gjithashtu ta kisha fshatin tim të organizuar dhe të përgatitur në rast të ndonjë sulmi apo emergjence, vendosa të shkoja në Glllogjan për ta diskutuar këtë çështje me Shtabin lokal të UÇK-së dhe për t'iu bashkangjitur UÇK-së..

Samir

SH

Ata

23. Këtë e bëra edhe për arsye të disa metodave të dyshimta që po përdorte UÇK-ja për t'i bërë njerëzit t'i bashkoheshin UÇK-së. Njëra nga këto metoda ishte se, gjatë natës, ushtarët e UÇK-së shkonin nëpër fshatra apo nëpër shtëpitë e disa fshatarëve që ende nuk i ishin bashkuar UÇK-së. Ata shtinin disa herë me armë dhe pas kësaj largoheshin nga ai vend.

24. Është e qartë se kjo shkaktonte shumë turbullira në fshat, por gjithashtu e alarmonte MPB-në që vinin në vend të ngjarjes bërë të bërë hetimet. Oficerët e MPB-së shpesh ngacmonin, keqtrajtonin dhe arrestonin shqiptarë të pafajshëm lokalë për të zbuluar se kush i kishte bërë të shtënat. MPB-ja asnjëherë nuk ka shkuar në fshatrat ku e dinin se kishte civilë të armatosur. Kur e dinin se nuk kishte rezistencë të armatosur fare, ata vinin dhe keqtrajtonin fshatarët lokalë. Meqë shumë shqiptarëve u erdhën të hunda ngacmimet apo keqtrajtimit, si nga UÇK-ja ashtu dhe nga MPB-ja, më në fund vendosnin të shkonin në Glllogjan t'i bashkoheshin UÇK-së.

25. Ngjarje të ngjashme ndodhën po ashtu në fshatin tim. Për shembull, një natë nga mesi i prillit të vitit 1998, Deli LEKAJ dhe Zymer UKAJ nga Lumbardhi, erdhën te shtëpia e vëllait tim. Përpara shtëpisë së vëllait tim filluan të shtinin në breshëri me armët e tyre automatike. Askush nuk qe dëshmitar i kësaj por më vonë ata ma konfirmuan personalisht, pasi që i isha bashkuar UÇK-së. Kjo ishte po ashtu njëra nga arsyet pse shkova ta shihja shtabin e UÇK-së në Glllogjan.

26. Kam dëgjuar për ndalimin dhe vrasjen e një femre shqiptare, të quajtur Sanije Balaj nga fshati Strelc. Ajo është kapur diku në qershor të vitit 1998 dhe më vonë është vrarë. Sipas thashethemeve Faton MEHMETAJ dhe Metë KRASQNIQI nga fshati Vranoc po ashtu janë të involvuar në këtë krim. Pretendohet se Metë Krasniqi dhe të tjerët e kanë arrestuar dhe e kanë mbajtur atë sipas urdhërit të Faton Mehmetajt. Kam dëgjuar se Metë Krasniqi është vrarë pas luftës. Thuhet se ajo është arrestuar dhe është ekzekutuar sepse dyshohej se i jepte informacion MPB-së dhe Policisë sekrete. Trupi I saj u gjet në fillim të gushtit 1998 në mallet pranë fshatit Baran.

Zymer UKAJ

Kh



[Signature]

27. Kur e kam pyetur Faton Mehmetajn se çka kishte ndodhur me Sanije Balajn, ai tha se ajo dyshohej se ishte spiune dhe bashkëpunonte me Sigurimin Shtetëror dhe MPB-në dhe se prandaj duhej të eliminohej. Ai tha se ia kishte dhënë urdhrin Metë KRASNIQIT për ta arrestuar dhe për ta eliminuar. Më vonë jam takuar me Metë Krasniqin, i cili ma ka konfirmuar se ai e kishte arrestuar dhe kishte eliminuar Sanije Balajn sipas urdhërit të Faton Mehmetajt. Metë Krasniqi gjithmonë ishte në uniformë të zezë të Policisë Ushtarake të UÇK-së dhe gjithkush nga Lugu i Baranit e dinte se ai ishte anëtar i Policisë Ushtarake të UÇK-së.

28. Metë Krasniqi jetonte në fshatin Vranoc, që ishte pjesë e nënzonës sime. Pasi që prindërit e Sanije Balajt më kishin pyetur se çka kishte ndodhur me bijën e tyre, unë e pyeta atë për këtë çështje.

29. E di se shumë njerëz ishin vënë në “lista të zeza” nga Faton Mehmetaj dhe Fitnete RAMOSAJ, siç e përmenda më sipër, zyrtarisht pse nuk i ishin besnikë UÇK-së apo pse e simpatizonin LDK-në apo pse kishin punuar për MPB-në apo organe të tjera të autoritetve. Këto lista qarkullonin nëpër rojet e fshatrave të UÇK-së në fshatra specifike që e simpatizonin UÇK-në. Rojet duhej ta kontrollonin identitetin e individëve që udhëtonin nëpër fshatin e tyre dhe t’u refuzonin qasjen atyre emrat e të cilëve përmendeshin në këto lista. Qëllimi i kësaj procedure ishte të komprometonin apo të diskreditonin njerëzit e përmendur.

30. Emri im ka qenë në një listë të tillë po ashtu. Në fillim të majit të vitit 1998 më ka thirrur Faton Mehmetaj për marrje në pyetje. Faton Mehmetaj dhe një person i njohur me nofkën “UJKU” më morën në pyetje në lokalet e Hoxhës në xhaminë e fshatit Pozhar. Më morën në pyetje rreth arsyes pse isha larguar nga fshati për të qëndruar në Pejë për një kohë siç e përshkrova më lartë. Në atë kohë ende isha civil, që do të thotë se nuk isha bërë anëtar i UÇK-së ende. Mirëpo ata më akuzuan mua se i kisha dhënë informacion MPB-së në Pejë rreth UÇK-së, duke marrë parasysh se isha ish-oficer i APJ-së. E mohova këtë dhe u tregova se kisha qenë në Pejë për një trajtim mjekësor. Personalisht mendoj se ata donin që ta komprometonin personalitetin dhe reputacionin tim, sepse e dinin se isha i popullarizuar midis njerëzve nga rajoni im për shak të përvojës sime ushtarake (në APJ). Marrja në pyetje



zgjati dy orë, pas së cilës isha i lirë të shkoja. Nuk më keqtrajtuam, edhe pse jam marrë në pyetje në një mënyrë bukur kërcënuese.

31. Nuk di asgjë rreth rrëmbimeve dhe zhdukjeve të serbëve në rajonin e Dukagjinit, me përjashtim të rastit të dy serbëve, të quajtur Millosh (mbiemri i panjohur) dhe Slllobodan (mbiemri i panjohur) nga fshati Dashinoc, diku nga fundi i prillit apo fillimi i majit të vitit 1998. Kam dëgjuar dy storje të ndryshme për rrenanat në të cilat janë zhdukur. E para është se Deli LEKAJ, komandant i UÇK-së në fshatin Lumbardh, i shoqëruar nga ushtarët e tij (Haxh Lekaj, Zymer Ukaj, Sami Lekaj dhe disa të tjerë), ka shkuar në fshatin Dashinoc. Kanë qenë të armatosur dhe të veshur në uniforma të UÇK-së. Kanë hyrë në shtëpinë e Slllobodanit për ta plaçkitur. Kanë menduar se shtëpia kishte qenë e zbrazët pasi që besohej se serbët e kishin lëshuar fshatin Dashinoc.

32. Mirëpo, kur kanë hyrë në shtëpi është gjuajtur në të dhe Deli Lekaj është plagosur. Ata i janë përgjigjur zjarrit dhe gjatë kësaj thuhet se serbi i quajtur Slllobodan është vrarë. Deli Lekaj pastaj është dërguar në fshatin Pozhar ku është trajtuar nga mjeku lokal, Syl Berisha. Kjo është storja që Deli Lekaj ma ka treguar mua pastaj.

33. Kam dëgjuar po ashtu për rrëmbimin e dy serbëve në maj të vitit 1998. Ata kishin qenë duke vozitur një fugan Mitsubishi (kombi), kur janë rrëmbyer nga Nasim Haradinaj në rrugë prej Gjakovës për Deçan, diku te fshatrat Prilep dhe Rastavicë. Kam dëgjuar se ata janë marrë por nuk e di ku janë dëruar dhe as çka ka ndodhur me ta. Nuk ua di emrat atyre dy serbëve të rrëmbyer dhe nuk më kujtohet se kush më ka treguar për këtë.

34. Tahir ZEMAJ dhe ushtarët e FARK-ut vepronin po ashtu në zonën e Dukagjinit dhe FARK-u luftonte bashkë me UÇK-në kundër Ushtrisë Jugosllave dhe MUP-it po ata vepronin veç UÇK-së. FARK-U dhe UÇK-ja kishin strukturat e tyre ushtarake.

35. FARK-u përbëhej nga rreth 500 ushtarë që ndaheshin në tri brigada. Tre komandantët e tri brigadave ishin: Nazif RAMABAJA, Shtabi i brigadës së të cilit ndodhej në fshatin BARAN,

[Handwritten signature]


[Handwritten signature]

Shemsedin ÇEKAJ (ose ÇEKU), Shtabi i brigadës së të cilit ndodhej në fshatin ZHABEL, dhe Tahir ZEMAJ, Shtabi i brigadës së të cilit ndodhej në fshatin Prapaçan (në lokalet e shkollës fillore Jusuf Gërvalla).


36. Tahir ZEMAJ ishte në të vërtetë komandant i FARK-ut. Ai u jepte urdhra të tri brigadave. Rangu i tij brenda FARK-ut ka qenë Major. Ai ka pasë qenë ish-oficer i APJ-së, që ishte diplomuar në Akademinë Ushtarake të Beogradit si Toger dhe më vonë është promovuar në Kapiten i Klasit të Parë.

37. FARK-u operonte në BARAN, në pjesën midis fshatrave Loxhë dhe Llukë e Epërme, deri te fshati Gërgoc. Ka qenë po ashtu një njësit i FARK-ut i dislokuar në fshatrat Jasiq dhe Junik nën komandën e Rrustem Berishës dhe Agim Ramadanit, të cilët që të dy ishin komandantë të UÇK-së por megjithatë në vartësinë e Tahir ZEMAJT. Tahir Zeaj ishte ai që i jepte urdhërat për këtë njësit. Mua personalisht më ka rënë në vesh Tahir Zemaj duke i dhënë urdhëra këtij njësiti përmes telefonit satelitor nga fshati Prapaçan. Unë po ashtu e kam dëgjuar Rrustem Berishën duke e informuar përmbledhtazi Tahir zemën përmes telefonit satelitor.

38. Ushtarët e FARK-ut kishin të njëjtat uniforma të kamufluara si dhe ushtarët e UÇK-së. Ata madje kishin edhe shenjën e UÇK-së në uniformat e veta, sepse nuk dëshironin të trazonin UÇK-në të cilës nuk i pëlqente ardhja e FARK-ut në Kosovë dhe që e kundërshtonte dislokimin e FARK-ut.


10







VËRTETIM I DËSHMITARIT

Përkthyesi Maklen Misha më ka treguar se kjo deklaratë me 38 paragrafe në gjuhën angleze, të cilën e kam nënshkruar është identike me deklaratën në gjuhën shqipe që kam lexuar dhe një kopje të së cilës ma kanë dhënë. E kam dhënë këtë Deklaratë vullnetarisht dhe jam i vetëdijshëm se mund të përdoret në procedura juridike para Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekje Penale për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 dhe se mund të thirrem të jap dëshmi publikisht para Tribunalit, por unë nuk jam gati të dëshmoj përpara ICTY për arsye sigurie.

Nënshkrimi: /nënshkrimi/

Data: 17.04.2007



VËRTETIM I PËRKTHYESIT

Unë, Maklen Misha, përkthyes, vërtetoj se:

1. Jam i kualifikuar dhe i miratuar nga Sekretaria e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë Prej Vitit 1991, për të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
2. Më ka informuar Rrustem TETAJ se ai e flet dhe e kupton gjuhën shqipe.
3. Rrustem TETAJ ka vërtetuar se faktet dhe çështjet e paraqitura në këtë deklaratë janë të vërteta, me sa di dhe sa i kujtohet, dhe rrjedhimisht ka nënshkruar në vendet përkatëse.

Nënshkrimi: *Maklen Misha*
Data: 17-04-2007

[Handwritten signature] *[Handwritten initials]*